



# A MUND T'I SHPËTOJNË SERBËT E KOSOVËS INSTRUMENTALIZIMIT POLITIK?

## **SHPAT BALAJ**

Botuar fillimisht nga [Prishtina Insight](#), 25. 08. 2023

*Nga instrumentalizimi politik deri te marginalizimi, komuniteti Serb në Kosovë lufton të vendosë për fatin e vet politik. Ndikimi i Serbisë përmes grupeve të kimit të organizuar dhe Kishës Ortodokse Serbe e shuan agjensinë politike të serbëve lokal.*

Komuniteti Serb në Kosovë është shpesh i anashkaluar gjatë situatave të pasigurta politike.

Ky komunitet mendon që nuk është i përfaqësuar në mënyrë adekuate në Kosovë dhe që institucionet qendrore po dështojnë në tentativat e tyre për të promovuar komunikim të qartë e efektiv mes grupeve të ndryshme etnike, sipas një [sondazhi](#) të realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Në anën tjetër, ky komunitet ka një perspektivë më pozitive në mënyrën si komunat e tyre i trajtojnë marrëdhëniet ndëretnike. Të dhënat e sondazhit theksojnë rolin e komunave në promovimin e komunikimit të drejtpërdrejtë, duke siguruar përfaqësim adekuat dhe qasje në institucione.

Sidoqoftë, instrumentalizimi i komunitetit serb në Kosovë nga Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq ka dobësuar agjensinë politike të këtij komuniteti në nivel lokal.

Vrasja e politikanit serb të Kosovës Oliver Ivanoviç, pas një kampanje diskredituese të [inicuar](#) nga mediat e kontrolluara nga shteti serb, tregon se pragmatizmi politik në komunitetin serb në Kosovë përballet me rezistencë.

Vuçiqi dhe Partia e tij Progresiste Serbe, kontrollojnë Listën Serbe, LS, që është përfaqësuesja kryesore politike e komunitetit serb në Kosovë.

Pas vrasjes së Ivanoviçit, LS-ja, në thelb, mbeti zëri i vetëm politik i serbëve të Kosovës, duke ulur kështu diversitetin politik mes komunitetit. Ndërkohë, Vuçiqi e ka shfrytëzuar këtë për të shtyrë përpara axhendën e tij politike, duke prioritetizuar interesat specifike të ndërlidhura me vizionin dhe përfitimet personale politike të tij.

Këto interesa, si për shembull mbajtja nën kontroll e komunave të udhëhequra nga serbët, që dobësojnë institucionet e Kosovës dhe bllokojnë përpjekjet për një shoqëri gjithpërfshirëse, po bëhen më problematike në kohën e rritjes së tensioneve në komunat veriore të Kosovës.

Instrumentalizimi dhe ulja e pluralizmit në një rënë anë, dhe [perceptimet](#) negative të komunitetit serb ndaj Kosovës në anën tjetër, kontribuojnë në paqartësitë për pozitën dhe përfaqësimin e komunitetit serb në Kosovë.

Një dialog lokal mes komunitetit serb dhe institucioneve të Kosovës [ka mbetur ende pa u adresuar](#) nga Qeveria e Kosovës, duke ruajtur kështu distancën ekzistuese mes institucioneve dhe serbëve të Kosovës.

Krimi i organizuar është një mjet tjetër i shfrytëzuar politikisht, që ndikon ndjeshëm në komunitetin serb në Kosovë, e në veçanti në komunat me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës.

Milan Radoiçiç, zëvendëskryetari i Listës Serbe, është një figurë e njohur [e përfshirë në krim të organizuar](#) në veri të Kosovës. Pavarësisht se është i kërkuar nga autoritetet e Kosovës për krime të ndryshme, Radoiçiçi mbanë [një lidhje të fortë](#) me Presidentin Serb, e cila vë në pah fuqinë e tij politike.

Grupet e krimit të organizuar, që thuhet se janë të lidhura me elitat politike të Serbisë dhe udhëhiqen nga Radoiçiçi me bashkëpunëtorët e tij, kanë luajtur një rol kyç në minimin e integritetit të komunitetit serb në institucionet e Kosovës. [Dorëheqjet në masë](#) të pjesëtarëve serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, FSK-së, më 2018 pas një kampanje të dhunshme intimiduese; [lidhjet](#) mes grupeve kriminale dhe policisë në Mitrovicën e Veriut; thirrjet nga [figurat si Radoiçiçi](#) për bojkotim të zgjedhjeve lokale në komunat veriore dhe ngjarjet si [djegia e veturave](#) me targa të Kosovës në pronësi të qytetarëve serbë, janë shembuj të qartë të ndikimit të këtyre grupeve në jetën publike të komunitetit Serb.

Këta shembuj tregojnë se si grupet kriminale, të mbështetura nga politika, përdorin fuqinë e tyre për të mbajtur komunitetin serb në Kosovë në gjendjen e tij aktuale politike dhe sociale.

Roli i Serbisë shtrihet përtej ndikimit në strukturat politike lokale në Kosovë, pasi ky rol po ashtu lehtëson prezencën e ndikimit malinj brenda komunitetit serb. Gjatë pandemisë COVID-19, kur Kosova refuzoi vaksinat kineze për shkak të origjinës së tyre, Serbia ofroi [shpërndarje të paautorizuar](#) të vaksinave kineze për serbët e Kosovës në veri të Kosovës, pasi Kina përdori „diplomacinë e vaksinave“ për të rritur ndikimin e saj në rajon.

Ngjashëm, [Serbia financoi në mënyrë diskrete](#) një projekt për të pajisur komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës me teknologji mbikëqyrëse kineze, të parregulluar.

Për më tepër, qëndrimi pozitiv i Serbisë ndaj Ruisë ka lejuar [ndikimin rus](#) të depërtojë në komunitetin serb në Kosovë, sidomos mes liderëve politikë dhe grupeve të krimit të organizuar. Këto grupe dhe liderët politikë, të parë nga Serbia si mjete politike, janë rreshtuar dhe punojnë bashkë me interesat ruse.

Serbia, duke u bërë një shteg për këto fuqi të huaja, është duke e penguar progresin demokratik të Kosovës dhe vizionin e saj për t'u integruar në organizata ndërkombëtare.

Ky bllokim për integrim ndërkombëtar, jo vetëm që pengon progresin e përgjithshëm të Kosovës, por po ashtu e ndikon direkt komunitetin serb, duke e mbajtur atë larg nga dispozitat e sigurisë dhe zhvillimi potencial socio-ekonomik, të cilat mund t'i ofrojnë anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Ndikimi i Serbisë në komunitetin serb në Kosovë nuk është i limituar në akterët politikë dhe në lehtësimin e ndërhyrjeve të huaja. Ai po ashtu prekë aspektet kulturore dhe fetare, më së shumti përmes Kishës Ortodokse Serbe, KOS. KOS-i ka një rëndësi të madhe kulturore dhe fetare për komunitetin serb në Kosovë, dhe shihet si një organizatë [jetike dhe e besueshme](#) që përfaqëson shqetësimet e komunitetit më të gjerë.

Megjithatë, kjo pozitë me ndikim nuk vjen pa komplikime. [Lidhjet](#) e KOS-it me Kishën Ortodokse Ruse dhe [lidhjet](#) potenciale me grupet ekstremist të djathtë kanë ngritur shqetësime. Për më tepër, [dështimi](#) i institucioneve të Kosovës për të zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për parcelat e tokës për Manastirin e Deçanit ka shtuar një dimension politik për KOS-in, duke minuar më shumë rëndësinë e saj kulturore dhe fetare.

Injorimi i këtij vendimi jo vetëm që ngritë shqetësime ligjore, por gjithashtu shton edhe mosbesimin e izolimin që ndjehet nga komuniteti serb, duke vështirësuar më tej situatën aktuale dhe duke anashkaluar mundësinë e grupeve jo-politike si KOS-i të ndihmojnë në integrimin e vazhdueshëm të komunitetit serb në Kosovë.

Në këtë aspekt, ka nevojë për një ndarje të qartë të problemeve politike të lidhura me KOS-in nga jeta fetare e kulturore e serbëve të Kosovës. Më shumë përpjekje duhet bërë për të komunikuar në mënyrë efektive rëndësinë e aspekteve kulturore e fetare të komunitetit serb për popullsinë shumicë në Kosovë dhe për të krijuar kanale pozitive të komunikimit mes institucioneve dhe KOS-it.

Sfidat me të cilat përballet komuniteti serb në Kosovë kërkojnë vëmendje urgjente. Agjencia politike e këtij komuniteti duhet të ruhet dhe hendeku mes tyre dhe institucioneve të Kosovës të mbyllet. Instrumentalizimi i komunitetit serb, ndikimi i krimit të organizuar dhe prezenca e akterëve të huaj, pengojnë zhvillimin e një shoqërie kohezive dhe gjithëpërfshirëse.

Ekziston një nevojë e madhe për t'u fokusuar në veprimet që promovojnë dialogun duke mbrojtur të drejtat dhe qëllimet e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Duke inkurajuar angazhimin kuptimplotë, duke përmirësuar përfaqësimin politik dhe duke luftuar kundër ndikimeve malinje, Kosova mund të përpiqet të krijojë një mjedis më të drejtë për të gjithë qytetarët e saj.

**Shpat Balaj** është hulumtues dhe menaxher i projekteve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë. Ai ka kryer disa punime hulumtuese, dokumente të shkurtra politikash dhe artikuj mbi përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë, integritetin në sektorin e sigurisë, dezinformimin dhe çështjet e ekstremizmit të dhunshëm.

*Ky artikull është shkruar si pjesë e projektit „Ballkani Perëndimor në udhëkryq: kthimi demokratik dhe ndikimi i akterëve të jashtëm“ i udhëhequr nga Instituti i Studimeve të Sigurisë në Pragë, i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED). Për më shumë informacion, vizitoni:*

[www.balkancrossroads.com](http://www.balkancrossroads.com)